

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti Për Krimeve Të Rënda, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit R. H., për shkak të veprës penale Mbajtja në Pronësi Komtrollë të Pa Autorizuar të Armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.I.nr.258/2016 të datës 10.06.2016, pas shqyrtimit fillestar me datë 27.12.2016 në të cilën morën pjesë Prokurori i Shtetit Arian Gashi, dhe i pandehuri R. H., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: R. H., i biri i M. dhe R., e gjinisë V., i lindur me dt *data e lindjes...*, nga fshati B., Komuna P., me vendbanim në rrugën “.....” në V. (mbrapa G.S.), i martuar, baba i tre fëmijëve, i punësuar në firmën NTP “I.” me seli në P., i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal *numër personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: Nga data e pa përcaktuar e deri me dt. 27.04.2016 rreth orës 06:30 i pandehuri pa autorizim ka poseduar armë ashtu që: pas një kontrolli në shtëpinë e tani të dyshuarit nga ana e pjesëtareve të Policisë së Kosovës, në rrugën “...” në V., në P., i është gjetur dhe sekuestruar një revole e markës M-57,7.62mm, me një karikator dhe 9 fishek të kalibrit 4.62mm, me numër serik 8800 të cilën e mbante pa autorizim.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së.

Andaj gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur, neneve 7,17,21,41,43,46,73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK –së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit **R. H.**, i caktohet dënim në gjobë në shumë prej **500 € (pesëqind euro)**, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse të pandehurit nuk e paguajnë gjobën, gjykata do të zëvendësoj dënim në gjobë në dënim me burgim, ashtu që një ditë burgimi do t’i llogaritet me 20 € gjobë.

Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedure penale, dhe atë paushallin gjyqësorë në shumën prej **50 (pesëdhjetë) euro**, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komfor nenit 115 të KPPK-së konfiskohet:

Pistoleta e markës M-57,7.62mm, me një karikator dhe 9 fishek të kalibrit 4.62mm, me numër serik 8800.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.258/2016 të datës 10.06.2016, me të cilën ka akuzuar të pandehurin R.H., për shkak të veprës penale Mbajtja në Pronësi Komtrollë të Pa Autorizuar të Armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së .

Me datë 27.12.2016 Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë qështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PP.I.nr.258/2016 të datës 10.06.2016, ndërsa Kryetari I Trupit Gjykues pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri R.H. në shqyrtimin fillestar, ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i është vënë në barrë, duke shtuar se, armën e kishte pasur trashëgim nga babai i tij i ndjerë, që nga koha e para luftës, e kishte pasur në shtëpi, asnjëherë nuk e barte me vete, dhe prej pas luftës e tutje nuk e kishte marrur kurrë në dorë, i njëjti ka shtuar se kishte fejuar edhe fëmijët, dhe as aty kurrë nuk e kishte përdorur. I Premtojë Gjykatës se më nuk do të bie ndesh me ligjin, duke shtuar se armët nuk i ka qejf, për më tepër edhe i urrente.

Prokurori i çështjes Arian Gashi është pajtuar me pranimin e fajësis nga ana e të pandehurit, me arsyetimin se pranimi i fajësisë ka mbështetje ligjore.

Meqenëse se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën me të cilën është akuzuar, gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së ngase i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza siç janë: vërtetimi mbi marrjen e sendeve e dt.27.04.2016, akuza nuk ka shkelje të qartë ligjore apo gabim faktik, ndaj gjykata mori aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë për të pandehurit.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë, pendesën e shprehur nga ana e të pandehurit, premtimin se më nuk do të bie ndesh me ligjin, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoj një dënim në gjobë, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimin ndëshkimorë në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimorë në kuptim të preventivës gjenerale që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komfor nenit 115 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR.nr 368/16, datë 27.12.2016

Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.